



Datë: 28.05.2025
Numër Protokolli: 3605/2025

A.nr.656/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-Kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Çlirim Zeka-në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.656/2025 të datës 15.04.2025 të parashtruar nga ankuesi A.M, kundër organit të punësimi Agjencia Kosovare e Privatizimit, në çështjen juridike “*Kontestim Konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendorsjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 28.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.656/2025 të datës 15.04.2025 të parashtruar nga ankuesi A.M.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil A.M (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi), i punësuar në Agjencinë Kosovare të Privatizimit sipas Akt Emërimit të datës 30.12.2011 në pozitën e punës ‘*Udhëheqës i ekipit Likuidim*’ në Departamentin e Koordinimit Rajonal, përmes postës me datë 11.04.2025 ka parashtruar ankesë e cila në Këshill është pranuar më datë 15.04.2025 me numër protokolli 2486/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin ankimor kundër Njoftimit me Nr.01/2025 të datës 13.03.2025 për refuzim të aplikacionit për pozitën Drejtor Ekzekutiv, të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ndërsa me datë 20.05.2025 me numër protokolli 3277/2025, i njëjti ka parashtruar kërkesë me të cilën ka tërhequr ankesën me numër A.nr.656/2025 të datës 11.04.2025.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: “*Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë*”, vendosi për përfundimin e procedimit

administrativ të filluar sipas ankesës me numër A.nr.656/2025 të datës 15.04.2025, pasi që nga kërkesa e datës 20.05.2025 rezulton se ankuesi nuk ka interes juridik që të vazhdoj me këtë procedurë administrative.

Theksuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.656/2025

Çlirim Zeka

Procesmbajtës

Malsore Gashi Bajraktari

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit A.M;
- Agjencisë Kosovare të Privatizimit (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore); si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.